

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-116/12

Prishtinë

20 dhjetor 2012

Në çështjen juridike të:

D.S.

Paraqitësi i kërkesës /Pala ankuese

Kundër

S. Ç.

Pala përgjegjëse në kërkesë /Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/142/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA 28304, 28308, 28312 dhe 90111) të datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me datën ... dhjetor 2012 dhe në përputhje me Nenin 13.3 (c) UNMIK/REG/2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Nenin 12.2 i lidhur me Nenin 465.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/142/2012 lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrat KPA 28304, 28308, 28312 dhe 90111.
- 2- Vërtetohet vendimi i KPCC/D/R/142/2012 lidhur me lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA 28304, 28308, 28312 dhe 90111.
- 3- Pala ankuese duhet të paguaj shpenzimet e procedurës të cilat janë në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë Euro), brenda afatit 90 (nëntëdhjetë) ditore nga data e dorëzimit të aktgjykimit ose përndryshe përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 8 mars 2007 D. S. (paraqitësi i kërkesës) si anëtar i familjes i bartësit të së drejtës pronësore (BDP) M. D. S.(babai i ndjerë i paraqitësit të kërkesës), ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon ri-posedim të ngastrave 33/2, 34/4; 35/1, 35/2, 35/3, 35/4; 33/1, të ndodhura në Broliq, Pejë të gjitha me kulturë kullosë. Pretendohet se në ngastrën 33/1 ekzistonte një shtëpi e cila ishte shkatërruar gjatë luftës në vitet 1998/1999. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se babai i tij ishte pronari i vetëm i ngastrave dhe tani ato janë të uzurpuara. Ai ka paraqitur një Fletë Poseduese nr. 46, të lëshuar nga Enti Gjeodezik i Serbisë më 12 shkurt 2012 në emër të babait të paraqitësit të kërkesës, për sa i takon ngastrave të përmendura më lartë.

AKP e kishte proceduar kërkesën. Në përgjigje të notifikimit S. Ç. ka pretenduar se në vitin 1979, babai i tij D. Ç., kishte blerë këto prona nga M.D. S.. Ai nuk ka prezantuar asnjë provë të shkruar në lidhje me atë. Ai ka theksuar se ekzistonte një kontratë me shkrim por ajo ishte djegur gjatë luftës.

Në përgjigje ndaj pretendimeve të S. Ç., paraqitësi i kërkesës ishte përgjigjur se ai nuk e di që babai i tij të kishte shitur pronat. Ai gjithashtu kishte shpjeguar se ai ka qenë duke jetuar në Serbi që nga viti 1970, se babai i tij kishte mbetur në Kosovë ku kishte vdekur në vitin 1989. Nuk është konstatuar qartë nga cila periudhë kohore familja e palës përgjegjëse në kërkesë (familja Ç.) kishte filluar të shfrytëzonte këto prona por është e pakontestueshme – paraqitësi i kërkesës nuk e kundërshton këtë, se familja e palës përgjegjëse në kërkesë ka qenë duke shfrytëzuar pronat shumë kohë para konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999 dhe para vitit 1989.

Me një vendim grupor KPCC/D/R/142/2012 të datës 29 shkurt 2012 për sa i takon lëndës të regjistruar në AKP me numrat KPA 28304, 28308, 28312 dhe 90111), KKPK ka pranuar se kërkesat bien jashtë mandatit të Komisionit siç përcaktohet me Nenin 3.1 të UNMIK/REG/2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni vëren se nuk ka prova të humbjes së posedimit apo pamundësi për të ushtruar të drejtat pronësore mbi pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit prandaj kërkesat bien jashtë kompetencës së Komisionit.

Pas vendimit grupor, më 24 maj 2012, KKPK lëshoi një vendim individual.

Vendimi i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 6 gusht 2012.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një ankesë më 3 shtator 2012.

Vendimi apelohe mbi bazën e “aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale”, “vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike” dhe “mospërputhjes në mes të dispozitivit dhe arsytimit të vendimit”.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës 30 ditore të paraparë me Nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK është i drejtë, lëndët nuk janë brenda kompetencës së KKPK-së.

Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon të drejtën në pronësi por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Sipas nenit 2, Parimet e Përgjithshme, pika 2.1 të Udhëzimit Administrativ 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 “çdo person i cili ka pasur të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejthe tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”.

Teksti në mënyrë të qartë e dëshmon se qëllimi i këtij ligji të veçantë (Rregullores) është të siguroj kthimin e të drejtave pronësore që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërlidhen me luftën e viteve 1998/1999.

Ky ligj i veçantë nuk shërben për zgjidhjen e pronës konvencionale apo kontesteve që kanë të bëjnë me pronën konvencionale, të cilat janë nuk janë në asnjë mënyrë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur. Ato konsiderohen se marrin zgjidhjen e tyre në kuadër të kornizës së legjislacionit të përgjithshëm

ekzistues mbi pronën, si për shembull Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Ligji No.03/L-154 i 2009, GZ nr. 57/2009).

Në rastin aktual është e pakontestueshme se prona në fjalë ishte e zënë nga familja e palës përgjegjëse në kërkesë (Ç.) shumë para konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999, madje edhe para vitit 1989, kur mbajtësi i pretenduar i së Drejtës Pronësore (babai i paraqitësit të kërkesës) ishte ende gjallë. Përkundrazi, në të njëjtin moment kohor – do të thotë shumë para luftës së viteve 1998/1999 dhe para 1989 familja e paraqitësit të kërkesës (S.) kishte pushuar së ushtruar posedimin mbi këto prona. Kjo nuk do të thotë se kur është bartur posedimi ishte bartur gjithashtu edhe e drejta mbi pronën. Posedimi është një gjendje e thjeshtë faktike e cila mund të shndërrohet në pronësi vetëm kur të jenë plotësuar kushtet e së drejtës materiale – kushtet për këtë dallojnë në vende të ndryshme por zakonisht ato përfshijnë posedimin me mirëbesim, apo të ligjshëm për një periudhë të caktuar kohore – *p.sh.* sipas Nenit 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Ligji nr..03/L-154 i 2009, GZ nr. 57/2009) kjo periudhë është 20 apo 10 vite (periudha e afatshkurtër është nëse posedimi është sipas një regjistrimi të caktuar). Periudhat e njëjta kohore ishin të aplikueshme sipas Nenit 28 të Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (GZ, RSFJ, nr. 6/1980).

Megjithatë në këtë rast është e parëndësishme nëse pala përgjegjëse në kërkesë apo babai i tij kanë përfituar të drejtën e pronës mbi bazë të fitimit me parashkrim dhe anasjelltas nëse paraqitësi i kërkesës është ende pronari i ligjshëm. Kjo, nëse në të ardhmen mbetet një kontest në mes të z. S. dhe z. Ç. duhet të zgjidhet përmes një padie të rregullt civile para një gjykate të rregullt civile.

Kompetenca e KKKP-së dhe Panelit aktual përjashtohet jo për arsye se paraqitësi i kërkesës dhe *anasjelltas* pala përgjegjëse në kërkesë është apo nuk është pronar i pronës por për shkak se **humbja e posedimit dhe pamundësia që të ushtrohet e drejta e pronësisë** deri në kohën kur është paraqitur kërkesa, **nuk ndërlihet në asnjë formë** me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.

Në konstatim KKKP duke e hedhur poshtë kërkesën për shkak se bie jashtë kompetencës së saj, ka marrë vendimin e drejtë dhe të ligjshëm.

Duke ndjekur të njëjtën linjë – për shkak të mungesës së kompetencës, gjykata nuk vendos nëse pala ankuese është pronari i pronës së kërkuar ose jo.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe

Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €. Kjo shumë është përcaktuar në pajtim me Nenin 10.11 të UA 2008/2 (për sa i përket shpenzimeve që duhet paguar për ushtrimin e ankesës).
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.15, 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të llogaritet të jetë € 19610: € 30. Kjo shumë është përllogaritur në pajtim me nenin 10.21 (për sa i takon shpenzimeve për nxjerrjen e vendimit në procedurën e apelit), 10.15 (për sa i përket shpenzimeve, që duhet të paguhet në rastet e hedhjes së padisë) dhe 10.1 (që përshkruan rregullat e përgjithshme të përllogaritjes së shpenzimeve) të UA 2008/2.

Këto tarifa gjyqësore merren përsipër nga pala ankuese i cili dihet t'i paguaj ato brenda 90 ditësh nga dita që aktgjykimi i dorëzohet atij.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it